



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PUKË  
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 062 prot.

Pukë, më 23.03 2022

PROJEKT - VENDIM

Nr. 03 Datë 23.03.2022

PËR DHËNIE TITULLI QYTETAR NDERI I BASHKISË PUKË

Z. OVE JOHAN HRESTAD

Këshilli i Bashkisë Pukë në zbatim të Nenit 54, pika "m" të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; të nenit 3, pika 1; nenit 14, pika 1; nenit 15, pika 1/a dhe 2; nenit 16, pika 1; nenit 17; nenit 18; nenit 19; nenit 20, pika "ç"; të ligjit nr. 112/2013 "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; të nenit 113, pika "dh", të ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, me Propozim të Kryetarit të Bashkisë:

V E N D O S I

1. T'i jepet titulli "Qytetar Nderi" i Bashkisë Pukë, Z. OVE JOHAN HRESTAD me motivacionin:  
**"Për kontributin e dhënë që në vitet e para të tranzicionit, përmes misionit të tij si dhe me dhurimin e mjeteve autoambulancë për shërbimin spitalor të banorëve të Bashkisë Pukë"**
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55 pika 6, e ligjit nr.139/2015 "Për Veteqeverisjen Vendore".

Drejtor DMBNJ  
Emirjona Pergjegjaj

Jurist  
Aida Sinani

KRYETARI  
Gjon GJONAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PUKË  
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 662/L prot.

Pukë, më 23.03.2022

**Relacion**

**PER MIRATIMIN E PROPOZIMIT PER DHENIE TITULLI " QYTETAR NDERI"**

**Z. OVE JOHAN HRESTAD**

Mbështetur në ligjin nr. **139/2015** "Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin **112/2013**, "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendore te nderit ne Republiken e Shqiperise", (ndryshuar me ligjin nr. **10/2015**, date **19.2.2015**), pas vlerësimit të kërkesës së bërë për dhënien e titullit qytetar nderi **Z. OVE JOHAN HRESTAD** me qëllim që të vlerësohet puna dhe kontributi i tij, Këshilli i Bashkisë duke konsideruar propozimin, ju propozon anetarëve të Këshillit që të vlerësohet figura dhe personaliteti, duke ju dhënë titulli i nderit ne shenjë respekti dhe mirënjohjeje publike per te gjithë kontributin, **Z. OVE JOHAN HRESTAD**, i lindur me datë **18.12.1957**, per punën misionare - vullnetare, ne mbeshtetje te popullit Pukjan.

Me propozim te Drejtorise se Menaxhimit te Burimeve Njerezore:

T'i jepet titulli "Qytetar Nderi" i Bashkisë Pukë, **Z. OVE JOHAN HRESTAD** me motivacionin:

**"Për kontributin e dhënë që në vitet e para të tranzicionit, përmes misionit të tij si dhe me dhurimin e mjeteve autoambulancë për shërbimin spitalor të banorëve të Bashkisë Pukë".**

Ky titull jepet në shenjë nderimi dhe vlerësimi për gjithë punën dhe kontributin e dhënë ne kohe te veshtira, **Z. OVE JOHAN HRESTAD**.

1. Per te gjitha meritat propozohet ti akordohet titulli "Qytetar Nderi i Bashkise Puke".

**Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerezore**

**Emirjona Pergjegjaj**